

# **PROPOZIM I POLITIKAVE PËR ARSIMIN E INTEGRUAR**

**DIALOGË PËR VIZIONIN**

**INSTITUTI PËR POLITIKA EVROPIANE**

**FUSHA: KOHEZIONI SOCIAL**

**TEMA: ROLI I PUSHTETIT LOKAL NË ARSIMIN (E INTEGRUAR) NË REPUBLIKËN E  
MAQEDONISË**

Ekipi hulumtues:

Prof. inordiner Dr. Goran Janev

Mr. Sonja Stojadinoviq

Mr. Aneta Smit Guleva

Shkup, Mars 2016

## **Vizioni**

Krijimi i kushteve për arsimin inkluziv të bazuar mbi vet-organizimin, stimulimin e iniciativave tek nxënësit dhe prindërit e tyre si faktorë aktivë të shoqërisë. Stimulimi i vetëdijes qytetare, e cila do t'i tejkalojë kufijtë e ndarjeve etnike. Socializimi esencial dhe procesi edukativo-arsimor që krijojnë individë të vetëdijësuar nga aspekti social, ekologjik dhe shoqëror, të cilët bashkësinë shoqërore nuk e nënkuptojnë si grup etnik/konfesional/gjuhësor. Veprimi në nivelin mikro, i mundësuar përmes aktiviteteve inkluzive jashtë-mësimore, e nxitë vetëdijen për individë të fuqishëm të cilët nuk varen nga shteti dhe institucionet, por janë faktorë proaktivë të ndryshimeve pozitive në mjedisin e tyre të drejtpërdrejtë. Krijimi i bashkësisë funksionale qytetare, si bazë për zhvillimin e marrëdhënieve demokratike shoqërore, meqë demokracia nuk e nënkupton vetëm votimin e përfaqësuesve politikë.

## **Analiza**

Për nevojat e këtij studimi është analizuar korniza juridike dhe struktura organizative e sistemit arsimor, praktikat ekzistuese të arsimit të integruar, siç emërtohen zyrtarisht, dhe hulumtimi në terren përmes intervistave me mësimdhënës, si aktorë përmes të cilëve ndryshohet implementimi i të gjitha aktiviteteve në institucionet edukativo-arsimore. Mësimdhënësit e anketuar vijnë nga shkolla të mjediseve të përziera. Me këtë hulumtim u përfshinë katër qytete: Tetova, Kumanova, Velesi dhe Dojrani. Gjatë përpilimit të propozim politikave tona u nisëm nga mundësitë në sistemin ekzistues dhe për këtë ofrojmë veprim në pjesën e aktiviteteve jashtë-mësimore. Qasja jonë i referohet *teorisë së kontaktit*, e cila konfirmon dhe dëshmon se gjatë ekspozimit të rritur të diversiteteve reduktohen barrierat shoqërore dhe minimizohen stereotipat dhe paragjykimet paraprake.

### **- Arsimi i centralizuar**

Sistemi ekzistues politik dhe centralizimi i tij, fuqimisht i shprehur, pasqyrohet edhe në strukturën organizative të sistemit arsimor. Kontrolli dhe rishpërndarja e obligimeve në arsimin fillor është vendosur si piramidë në majën e së cilës është Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ministri i aprovon planet dhe programet mësimore, por me propozim të Byrosë së Zhvillimit të

Arsimit. Byroja e Zhvillimit të Arsimit i propozon planet mësimore sipas së cilëve duhet të punojnë shkollat. Kontrollin kryesor mbi punën e përgjithshme të shkollave e bën BZHA, ndërsa Inspektorati Shtetëror i Arsimit është i ngarkuar për kontrollin e kushteve në të cilat zhvillohet procesi arsimor. Financimi rregullohet përmes bllok dotacioneve, të cilat sigurohen nga Buxheti i shtetit, të cilat përcaktohen sipas dendësisë së popullsisë, sipas numrit të banorëve dhe numrit të nxënësve në komunë. Shkollat varen nga këto bllok dotacione, meqë ato janë burimi kryesor i financave, të cilat i pranon shkolla, mjete këto të cilat janë të ndara nga pagat e kuadrit edukativo-arsimor në shkollë. Prindërit marrin pjesë në punën e shkollës përmes anëtarësimit në Këshillin e Shkollës dhe Këshillin e Prindërve, megjithatë ndikimi i tyre përfundon në pjesën e votimit për furnizimin e ushqimit, materialeve të punës, ekskursione dhe parashtrimin të propozimeve për të njëjtat.

Analiza, sa i përket kornizës juridike, vë në dukje se sistemi arsimor, veçanërisht në pjesën e arsimit fillor, është shumë i centralizuar në aspektin e miratimit të vendimeve në lidhje me aktivitetet jashtë programit të parashikuar. Nevojitet decentralizim, liri më e madhe për mësimdhënësit për realizimin e aktiviteteve të cilat rezultojnë nga propozimet e prindërve, nxënësve dhe vet mësimdhënësve, bashkë me lirinë financiare të shkollave për ta pasur në dispozicion hapësirën e tyre. Kjo liri financiare do të krijojë hapësirë për realizimin e lirë të aktiviteteve jashtë-mësimore pa pasur varësi nga dotacionet buxhetore dhe financat e projekteve.

#### - Politikat e integritit të cilat i përforcojnë dallimet

Në mënyrë që të rritet integrimi në shoqërinë multietnike maqedonase, në vitin 2010 u miratua Strategjia në të cilën janë inkorporuar disa parime për krijimin e kohezionit në shoqëri, siç janë: promovimi i integritit, përshtatja e programeve mësimore dhe teksteve shkollore, ngritja e njohurive, vetëdijesimi dhe qasja e mësimdhënësve dhe veprimi i bashkërenditur nga niveli qendror në atë lokal me kompetencat komunale të procesit të decentralizimit. Megjithatë, respektimi i çiltër dhe eksplicit i këtyre parimeve nuk do të kontribuojë shumë ndaj kohezionit, meqë akoma një pengesë e madhe është partizimi i pozitave kyç të shkollave. Strategjia, përveç faktit që nuk mbështetet në hulumtime dhe analiza serioze dhe gjithëpërfshirëse ajo bazohet edhe në premisën e gabuar se qytetarët në Maqedoni janë të fiksuar në grupe etnike dhe se kjo përkatësi është primare dhe e patjetërsueshme. Qasja jonë është mbietnike dhe plotësisht i hedhë

poshtë këto ndarje, duke insistuar në vlerat universale të cilat kanë karakter bashkues shumë më të madh sesa qasja ekzistuese e integritit, e cila përpiket të ngjisë pjesë të veçanta.

Implementimi i kësaj Strategjie realizohet edhe përmes mbështetjes së huaj me tre projekte: Projekti për Arsimin e Integruar Ndëretnik (PAIN), Modeli Nansen për Arsimin e Integruar (MNAI) dhe Fondi “Ndërtojmë Ura”. Projekti i parë PAIN është implementuar nga viti 2011 deri në vitin 2015 nga ana e Ministrisë së Arsimit, ndërsa target grupe janë shkollat fillore dhe të mesme, nxënësit, mësimsdhënësit, anëtarët e këshillave shkollorë, prindërit dhe bashkësitë lokale. Megjithatë, ky Projekt në masë më të madhe i ka detektuar problemet e nxënësve, ndërsa në masë më të vogël ato të prindërve, mësimsdhënësve, ndërkaq më së paku problemet e komunës. Kjo paraqet problem meqë puna normale e shkollës, në masë të madhe, varet edhe nga puna e komunës, me të cilën është e lidhur në mënyrë të pandashme. Rezultatet dëshmuar se mediat në nivel lokal akoma një theks të madh vënë mbi dallimet etnike dhe konfliktet etnike, ndërsa theks më të vogël vënë mbi integrimin. Këtu ndikim të madh ka edhe pakënaqësia e manifestuar nga ana e mësimsdhënësve të cilët e kanë ndjerë presionin nga ana e institucioneve kompetente, sa i përket implementimit të suksesshëm të këtij Projekti. Është nënvizuar edhe mosbesimi i prindërve ndaj shkollës dhe të punësuarve, mungesa e përfshirjes së tyre në projektet e shkollës dhe në procesin e vendimmarrjes.

Projekti i dytë i Modelit Nansen për arsimin e integruar, ndërkaq Dialogun Nansen Qendra e implementon nga viti 2007 në 12 shkolla fillore. Parimi i funksionimit të këtij modeli bazohet mbi ndjekjen e mësimit në gjuhën amtare të nxënësve nga etnitete të ndryshme në një shkollë të njëjtë, në kohë të njëjtë. Programet u janë përshtatur interesave të nxënësve dhe të njëjtit janë përpiluar bashkë me prindërit dhe mësimsdhënësit, qasja është dygjuhësore, ndërkaq është përfshirë edhe metoda e lojës.

Projekti i tretë realizohet përmes Fondit “Ndërtojmë Ura”, i cili realizohet sipas parimit të përfshirjes së drejtpërdrejtë të faktorëve në nivel lokal, bashkë me nxënësit, mësimsdhënësit dhe shkollat në aktivitete të përbashkëta, të cilat stimulohen përmes Fondit. Aktivitetet realizohen midis dy shkollave të ndryshme shumë-gjuhësore ose përmes dy shkollave të vëllazëruara një-gjuhësore.

Megjithatë, problemet kryesore gjatë zbatimit të programeve të lartpërmendura janë mungesa e motivimit të nxënësve për ato programe (nxënës, mësimitdhënës, prindër), centralizimi shumë i madh dhe formalizimi në çdo pjesë të miratimit dhe zbatimit të vendimeve, bashkë me ndarjet etnike, të cilat akoma më shumë kontribuojnë në problemet.

#### - Potenciali i pashfrytëzuar koheziv

Analiza, në këtë studim, vazhdoi në drejtim të intervistave me disa mësimitdhënës të shkollave fillore në Tetovë, Kumanovë, Veles dhe Dojran, të cilat punojnë në mjedise dhe shkolla etnikisht të përziera. Pasqyra e sublimuar e cila rezultoi nga pyetjet e parashtruara, të cilat i përfshinin pjesët e interaksionit midis fëmijëve, konfliktet ekzistuese ose mungesën e tyre, interesimin dhe përfshirjen e prindërve në punën e shkollës dhe arsimin e fëmijës së tyre, si dhe rolin e komunës në këtë proces gjithëpërfshirës të integruar arsimor, e dha pasqyrën si vijon. Në të gjitha qytetet e cekura, më saktë në shkolla, fëmijët nuk kanë probleme në komunikimin e tyre të ndërsjellë, nuk ka konflikte, përveç shkollave me përbërje të përzier etnike ka edhe shkolla të cilat janë pastër shqiptare ose maqedonase, në të cilat fëmijët nuk përzihen midis tyre dhe ku për fat të keq nuk ka kurrfarë kontakti midis fëmijëve. Programet e integritit pjesërisht kanë ndihmuar që fëmijët të integrohen dhe të mposhten barrierat midis tyre, më së shumti në aktivitete të cilat e përfshijnë mësimin e një gjuhe të tretë dhe në aktivitete sportive, megjithatë ka shumë hapësirë për të punuar në këtë fushë. Është vërejtur mungesë e madhe sa i përket përfshirjes së prindërve në arsimin e fëmijëve, veçanërisht në pjesën e propozimeve për aktivitetet jashtë-mësimore, mungesë e financave për realizimin e aktiviteteve, si dhe liria e propozimit të aktiviteteve. Dëshira e fëmijëve që të mësojnë dhe të realizojnë aktivitete, të cilat dalin jashtë programeve mësimore është e madhe, dhe së këtejmi mbështetja e prindërve, mësimitdhënësve, si dhe e komunës është kryesore sa u përket financave.

#### **Mundësitë e ardhshme**

Meqë sistemi është skajshëm i centralizuar, propozojmë të vepohet atje ku është e mundshme të përvetësohet më shumë hapësirë e lirë dhe të realizohen politikat të cilat do ta tejkalojnë hendekun etnik, në mënyrë të shpejtë dhe efikase, pa bërë ndërhyrje në ndryshimin e strukturës ekzistuese organizative të marrëdhënieve në sistemin arsimor, në të cilin shkollat skajshmërisht kanë varësi edhe në aspektin financiar edhe në atë administrativ nga pushteti qendror. Fakti, se edhe përkrah tentativave publikisht të përcaktuara për arsimin e integruar, ne kemi një sistem

arsimor skajshëm të segreguar, e vë në dukje mungesën e vullnetit të mirëfilltë ose mungesën e njohurive për zvogëlimin e hendekut. Prandaj, propozojmë të minimizohet roli i mekanizmave ekzistues institucional dhe veprim në mikro mjedise në të cilat vetvetiu do të propozohen dhe zbatohen aktivitete jashtë-mësimore, të cilat përveç faktit që do t'i afrojnë nxënësit dhe shoqërinë më të gjerë, do të kontribuojnë edhe në drejtim të vetëdijesimit më të lartë për një sërë çështjes të cilat i tejkalojnë ndarjet etno-politike. Lirimi nga varësia, për aktivitete programore dhe për financimin e tyre dhe ndërmarrjen e iniciativave në mikro nivel, e garanton qëndrueshmërinë e aktiviteteve jashtë-mësimore të bazuara mbi parimet e vetë-organizimit.

### **Mundësitë e politikave**

Implementimi i aktiviteteve të propozuara është po aq i madh meqë përfshin një pjesë e cila edhe pse i nënshtrohet kontrollit, nuk është rregulluar në mënyrë strikte, sa i përket përmbajtjes. Fushat e propozuara të veprimit, në mënyrë plotësuese, bazohen mbi vlerat dhe nevojat universale njerëzore. Selektimi primar i mbetjeve, prodhimi vetjak i perimeve ose ndihmë për personat e pamundur ose të vetmuar, rampa për hyrje-dalje në shkolla dhe në komunë dhe aktivitetet e tjera të mundshme, të cilat nuk dëshirojmë t'i prejudikojmë dhe imponojmë por ato ua lëmë t'i zgjedhin vet nxënësit/mësimdhënësit/prindërit, gjithsesi se janë fusha të cilat e obligojnë edhe pushtetin lokal të ofrojë mbështetje dhe ndihmë. Hapja e kornizës më të gjerë të procesit edukativo-arsimor, si një segment kyç në formimin e qytetarëve të kësaj shoqërie si individë të përgjegjshëm dhe solidarë, gjithsesi se do ta ketë mbështetjen e nevojshme nga shoqëria më e gjerë.

Vet procesi i marrjes së vendimeve, në lidhje me atë se për cilat aktivitete të organizohen nxënësit e instalon në praktikë demokracinë e drejtpërdrejtë participative. Propozohet përfshirja aktive e prindërve dhe nxënësve, në një proces në të cilin mësimdhënësit janë ndërmjetësues, por edhe palë e përfshirë. Bashkëpunimi në këtë nivel, me pjesëmarrje dhe ekspozim të drejtpërdrejtë të njëjës me palën tjetër dhe gjetjes së kompromisit dhe zgjidhjeve për çështje konkrete, si dhe vet procesi i implementimit i aftëson pjesëmarrësit për parimet dhe procedurat demokratike, e demistifikon demokracinë e tjetërsuar reprezentative dhe stimulohet krijimi i një bashkësie të unifikuar lokale.

## **Bërja e ndryshimit**

Për realizimin e këtyre aktiviteteve jashtë-mësimore në të cilat vet nxënësit do të jenë propozues të drejtpërdrejtë dhe zbatues të aktiviteteve, megjithatë duhet të modulohen dhe përshtaten kushtet ekzistuese sistematike. Së këtejmi, i vëmë në pah rekomandimet si vijojnë:

Rekomandime:

- Sistemi arsimor shumë i centralizuar dhe kontrolli mbi shkollat duhet të mundësojë një shkallë më të lartë të lirisë dhe mbështetje të iniciativave të cilat vinë nga poshtë lartë për aktivitetet jashtë-mësimore. Këtë do ta mundësojë zhvillimi i bashkësisë inkluzive dhe koherente, në vend të refleksionit të thjeshtë të ndarjeve etno-politike të pranishme në shoqëri.
- Procedurat burokratike dhe administrative, të cilat i rregullojnë çështjet e organizimit të aktiviteteve jashtë-mësimore, duhet të thjeshtëzohen. Rregullorja e metodës për realizimin e ekskursioneve dhe aktiviteteve tjera të lira për nxënësit e arsimit fillor fuqimisht varet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kjo procedurë duhet të jetë më e lehtë, në mënyrë që ta hap rrugën për një komunikim më pak të formalizuar, ndërsa kujdesi për sigurinë mbetet primar.
- Qasja mbi-etnike dhe mbi-nacionale në aktivitetet mësimore të stimulohet përmes angazhimit të temave të cilat shkojnë përtej ndarjeve të bazuara në përkatësi. Aktivitetet në fushat e temave universale, siç është mjedisi jetësor, inkluzioni social të cilat e theksojnë solidaritetin dhe empatinë duhet ta zënë vendin e qasjes aktuale “integrative”, e cila i thekson ndarjet etnike.
- Duhet të ekzistojë transparencë më e madhe për idetë të cilat aktualisht nuk stimulohen nga korniza etno-politike, e cila e formon shoqërinë maqedonase.
- Duhet të ketë më shumë hapësirë në mënyrë që të përfshihet bashkëpunimi me aktorët e tjerë të Shoqërisë civile në komunë, e cila stimulohet nga vet komuna, siç janë: organizatat e vëzhguesve, organizatat e profesionistëve sportivë, organizatat e artistëve, organizatat e mjedisit jetësor. Procesi i miratimit të vendimeve megjithatë, duhet të stimulohet në mënyrë kreative përmes diskutimeve në kuadër të këshillit të shkollës/prindërve, këshilla këto që

duhet të gjenerojnë dhe të vendosin me një moderim të vogël të atij procesi nga ana e shkollës.

- Komunat duhet të ndërmarrin përgjegjësi më të madhe, sa i përket procesit arsimor dhe të angazhohen në mënyrë më serioze në aktivitetet jashtë-mësimore, si njëra nga rrugët më të qëndrueshme drejt zhvillimit të një bashkësie më inkluzive në nivel lokal.
- Komunat duhet ta braktisin rolin e distributorit të bllok dotacioneve nga pushteti qendror dhe të bëhen proaktive sa i përket financimit dhe stimulimit të aktiviteteve inkluzive jashtë-mësimore. Një shumë e caktuar e buxhetit duhet të dedikohet prej poshtë lartë për aktivitetet inkluzive jashtë-mësimore, ndërsa një numër i caktuar i aktiviteteve duhet të implementohen në çdo shkollë.
- Përgjithësisht, rekomandojmë një qasje krejtësisht të ndryshme ndaj faktorëve të cilët në mënyrë demokratike miratojnë vendime në nivel të shkollës. Trekëndëshi, mësimdhënës-prindër-nxënës është i pranishëm në mënyrë strukturore, megjithatë nuk është efikas dhe në praktikë është jothelbësor. Veçanërisht, Këshilli i Prindërve duhet të ketë liri më të madhe në krijimin e ideve të cilat kanë të bëjnë me aktivitetet e lira jashtë-mësimore me ide minimale të kuadrit mësimor të shkollës, përkatësisht të mësimdhënësve. Në këto procese, nxënësit duhet të përfshihen që nga fillimi dhe në të gjitha fazat.
- Duhet të implementohen angazhime serioze në mënyrë që ekzistimi i Këshillit të Prindërve të fitojë peshë më të madhe. Duhet të perceptohet si mekanizëm demokratik për vendimmarrje participative në sistemin arsimor dhe të mos trajtohet për nevoja komerciale që kanë të bëjnë me hoteleri dhe sigurimin e shkollave në kuadër të procedurave të tenderimit.
- Për këtë qëllim, në mënyrë që të tejkalohet mungesa e besimit nga ana e prindërve në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me aktivitetet ndëretnike, duhet të ketë inkluzion progresiv të prindërve në procesin e miratimit të vendimeve, i cili do të zbatohet përmes ndryshimeve të legjislacionit në kuadër të Rregullores për metodën e realizimit të ekskursioneve dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore dhe të realizohet me kujdes të madh nga kuadri relevant i komunës, i cili e bën monitorimin dhe nga drejtori i shkollës.
- Në kuadër të Rregullores për metodën e realizimit të ekskursioneve dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore, hapësirë më e madhe duhet t'u lihet iniciativave të cilat vijnë nga nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit, në vend të vendimeve paraprakisht të aprovuara të cilat vijnë nga lartë poshtë.



- Revizion i listës së vendeve dhe monumenteve të aprovuara të cilat mund të vizitohen. Përzgjedhja e vendeve dhe monumenteve të aprovuara të cilat mund të vizitohen në kuadër të aktiviteteve dhe udhëtimeve/ekskursioneve të organizuara jashtë-mësimore në mënyrë kritike duhet të revidohet dhe të balancohet me një qasje shekullare, e cila duhet të respektohet në kuadër të procesit arsimor.
- Të përcaktohen më mirë rolet e asistentëve të drejtorëve në shkollat fillore. Ata duhet të jenë garanci për autonominë e procesit të miratimit të vendimeve në kuadër të këshillave shkollorë. Në mënyrë më precize të përcaktohet roli i tyre dhe përgjegjësitë në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike në bashkësitë në nivel komunal.

## **Evaluimi**

Evaluimi i nivelit të kohezionit shoqëror dhe bashkëpunimi interetnik janë kategori relativisht subjektive, që i nënshtrohen ndikimeve të drejtpërdrejta të jashtme. Megjithatë, prapë se prapë mund të zbatohet evaluim përkatës.

Fillimisht, evaluimi mund të zhvillohet në nivel sistematik, përkatësisht të detektohen ndryshimet e kushteve të lehtësuara për realizimin e aktiviteteve jashtë-mësimore, me ç'rast do të vlerësohen komunat dhe nxënësit. Evaluimi mund t'i kontrollojë depozitat e punës, ato administrative dhe financiare gjatë realizimit të aktiviteteve jashtë-mësimore, si në nivel të shkollës ashtu edhe në nivel të njësisë së vetëqeverisjes lokale, përkatësisht krijimi i një mjedisi stimulues për zhvillimin e aktiviteteve të këtitilla.

Pastaj, evaluimi mund të zhvillohet në nivel të analizës së proceseve, përkatësisht në nivel të inkluzivitetit të procesit, përfshirjes demokratike të të gjithë aktorëve të involvuar: mësimdhënës/prindër/nxënës. Evaluimi duhet të përmbajë kritere sa i përket përfshirjes dhe përfaqësimit të nxënësve dhe prindërve në procesin e miratimit të vendimeve, si dhe gjatë implementimit të aktiviteteve të përzgjedhura.

Evaluimi mund t'i masë projektet e realizuara dhe llojin e tyre, sipas esencës dhe sipas natyrës së projekteve inkluzive. Është mjaft e lehtë qasja në këqyrjen e numrit të aktiviteteve, llojit të tyre dhe efekteve eventuale të veprimit të aktiviteteve jashtë-mësimore.